



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:051512
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697056

E.nr.1121/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës L.T. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Fatos Pira Viti , kundër debitorit Komuna e Ferizaj- Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e shtesës për ushqim, pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 16.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1121/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1121/23, të datës 03.08.2023 e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e shtesës për ushqim , pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës , në bazë të aktgjykimit C.nr.689/20 të dt.13.04.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës, 16.10.2023 e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,172.75 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1121/23 më datë 16.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi